

20/10/2020

REAGIM MBI LAJMIN

DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE, I GJITHËPËRHAPUR NË ADMINISTRATË

Lajmi është publikuar nga Reporter. al më 19 tetor 2020

Galeria Kombëtare e Arteve pasi është njohur me artikullin e publikuar ditën e djeshme nga reporter.al e ndjen të nevojshme të reagojë mbi këtë lajm që paraqet informacione të pasakta.

Lidhur me rastin e ish-punonjësit Hysen Hajdaraj, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Ju sjellim në vëmendje se KMD në vendimmarrjen e saj nuk është shprehur se GKA ka ushtruar diskriminim ndaj Z.Hajdaraj si rrjedhojë e bindjeve politike, por ka konstatuar diskriminim në formën e viktimizimit për shkak të ankimimit të tij në gjykatë të një mase disiplinore dhënë gjatë marrëdhënieve të punës. KMD ka shqyrtuar ankesën e Z. Hajdaraj referuar pretendimit për diskriminim në formën e viktimizimit, dhe jo diskriminimit për bindje politike. Paragrafi i fundit marrë nga Vendimi i KMD-së:

“Ndërsa, për sa i përket parashtrimeve të palës ankuese në referencë të provimit të bindjeve politike të tij, të ndryshme nga punëdhënësi dhe parashtrimeve të drejtorit të GKA për sa i takon qënies së tij pa bindje politike të majta, Komisioneri, thekson se nuk u është referuar bindjeve politike të subjektit ankues, pasi ankesa e tij është shqyrtuar lidhur me pretendimin e tij për viktimizim, ardhur si pasojë e ankimimit të tij në gjykatë, kundër drejtorit të GKA, ku ka pretenduar diskriminim nga ky i fundit. Në këtë kuadër, Komisioneri ka hetuar dhe analizuar situatën e krijuar dhe pasojat që i kanë ardhur ankuesit pas ankimimit të tij në gjykatë.”

Vendosi:

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të H. H nga ana e Galerisë Kombëtare të Arteve (GKA), për shkak të ankimimit në gjykatë me pretendim diskriminim e tij.
2. Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Galerisë Kombëtare të Arteve, të merren masa për ndalimin e trajtimit diskriminues ndaj H. H, si dhe për sistemimin e tij në një ambient pune që përmbush kriteret e domosdoshme të të qenit ambjent i përshtatshëm pune.”

GKA e ka vlerësuar si të pabazuar në prova e fakte vendimin e KMD-së dhe ka depozituar ankimm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar ankesës së Z.Hajdaraj pranë KMD-së për diskriminim dhe trajtim të pabarabartë si pasojë e spostimit në një zyrë tjetër pune, nga ana jonë është sqaruar zyrtarisht KMD dhe i është vënë në dispozicion gjithë dokumentacioni dhe informacioni i nevojshëm për të vërtetuar se kjo lëvizje ka ardhur si rrjedhojë e pastrimit, aredimit dhe ristrukturimit të ndarjes së ambienteve të punës sipas përkatësisë sektoriale. Në asnjë moment, GKA nuk ka spostuar punonjës (z. Hajdaraj nuk është punonjësi i vetëm i spostuar nga zyra) për motivacion të rikonstruktimit të godinës, pasi ky proces nuk ndërmerret nga vetë GKA.

Ndërtesa e Galerisë Kombëtare të Arteve dhe ambientet e improvizuara ndër vite për të akomoduar një numër punonjësish relativisht më të madh në raport me hapësirën në dispozicion kanë qenë të amortizuara dhe të pa mirëmbajtura ndër vite. Të gjithë punonjësit punonin në zyra të ndryshme, pa ndonjë rregull sa i përket natyrës së punës që ata/ato bënin dhe nevojës së bashkëveprimet ndërmjet tyre. Të gjitha këto zyra nuk plotësonin standardet e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e punonjësve, por edhe kënaqësinë dhe motivimin që ata/ato duhet të kenë gjatë orarit zyrtar, veçanërisht në një institucion i cili në misionin e vet ka promovimin e artit. Gjithashtu niveli i lartë i papastërtisë i akumuluar ndër vite dhe sasia e madhe e letrave, mobilieve të vjetra dhe i materialeve të tjera përbënte rrezik për stafin, sidomos për krijimin e alergjive apo përkeqësimin e simptomave të individëve me probleme me frymëmarrjen. Pra, të gjitha ndërhyrjet u kryen me qëllimin e vetëm të plotësimit të kushteve të nevojshme për stafin. Paralelisht me planin e rregullimit të ambienteve të zyrave të GKA-së janë pyetur edhe punonjësit mbi nevoja specifike apo orendi të domosdoshme për kryerjen e detyrave. Në vijim të këtij plani ka nisur puna për pastrimin, lysterjen dhe aredimitin e zyrave. Theksojmë se procesi i ndarjes së zyrave dhe transferimit të punonjësve është në varësi të hapësirës fizike, punës që ata kryejnë dhe kushteve të vetë godinës së institucionit. Të gjitha zyrat gjenden në katin përdhës të GKA-së, përfshirë edhe zyrën ku qëndronte z. Hajdaraj. Aktualisht zyrat plotësojnë tashmë kushtet bazike për të gjithë punonjësit, pavarësisht pozicionit që ata/ato mund të kenë në strukturën institucionale të GKA-së, duke respektuar kështu parimin bazë në punë, atë të barazisë. Pas depozimit të ankesës nga ana e Z.Hajdaraj, në ambientet e GKA-së janë paraqitur përfaqësues të institucionit të KMD-së të cilët kanë kryer verifikimet përkatëse në të gjitha ambientet e punës së institucionit. Por, në vendimin e tyre është konstatuar vetëm mungesa e pajisjeve për ngrohje ftohje në zyrën e Z.Hajdarit, kur kjo problematikë paraqitet edhe në vendqëndrimin e rojeve si dhe në zyrën e Drejtorisë së Edukimit dhe Organizimit të Ekspozitave ku gjatë stinës së verës temperaturat në ambientin e brendshëm arrijnë deri në 40 gradë. Pra, KMD është treguar e njëanshme kur në rastin e mungesës së një sistemi apo pajisje për ngrohje ftohje në ambientet e mësipërme, e

identifikon si një problematikë që ekziston vetëm në zyrën e ish punonjësit z. Hajdaraj. I njëjti problem qëndron edhe me konstatimet e tjera, ku KMD ka qenë e njëanshme dhe ka favorizuar palën ankuese. Ju bëjmë me dije se tipologjia e zyrave të GKA-së ndryshon me zyrat e institucioneve të tjera shtetërore pasi zyrë apo ambient pune konsiderohet një ambient që është në varësi të detyrave që ka punonjësi, i cili në GKA në 70% të rasteve ka detyra fizike. Në këtë rast ambienti përshtatet për të lehtësuar punën e punonjësit që kryen detyrat funksionale. Psh. GKA disponon punishte ku qëndron tekniku i ekspozitave, atelie restaurimi (në të cilat gjenden gjithashtu kimikate) apo edhe laboratore për edukimin dhe ambient pune për Sektorin e Sigurisë dhe Mirëmbajtjes, i cili disponon një tualet shtesë për shkak të punës të sanitareve, pjesë e këtij sektori. Pra, për ta përmbyllur këtë arsyetim, GKA ka rregulluar të gjitha ambientet e saj të punës (brenda hapësirës dhe mundësive ekonomike që ka në dispozicion), ka ftuar Inspektoriatin e Punës për të inspektuar dhe t'u dhënë shtesë rroge për vështirësi pune punonjësve për të cilët inspektoriatin e ka menduar të arsyeshme, si dhe ka përmirësuar ambiente të tjera të përbashkëta (ka krijuar një ambient kuzhine; si dhe ka krijuar një kënd me ulëse në ambientet e jashtme në mënyrë që punonjësit të kenë akses në ajrim dhe dritë natyrale herë pas herë, duke qenë se të gjitha ambienteve të punës iu mungon drita dhe ajrimi i duhur natyral, si dhe janë të ekspozuara ndaj zhurmave të ndryshme). Këto janë fakte që provohen shumë lehtë, mjafton që dikush të bëjë një vizitë në GKA.

Galeria Kombëtare e Arteve mohon të ketë diskriminuar politikisht apo të ketë diskriminuar në forma të ndryshme punonjës të saj dhe do të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për të hedhur poshtë çdo pretendim të këtij lloji.

Lutemi që deklarata jonë të publikohet e plotë, dhe jo e shkëputur prej kontekstit.

Gjithashtu lutemi të hiqni foton e postuar ku paraqitet Drejtori i GKA-së, pasi nuk keni marrë leje për ta përdorur atë si imazh në artikullin tuaj. Më tej, në foto paraqitet gjithashtu një zyrtar i lartë i Republikës së Kosovës, e cila nuk ka lidhje me kontekstin e këtij shkrimi.